



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Tiranë më	
Nr.	protnumber

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN E QENDRAVE TË POSAÇME TË
VOTIMIT, HARTIMIN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE DHE KRIJIMIN E
KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT NË INSTITUCIONET E
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË
DATËS 11 MAJ 2025.

**1. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME
LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Referuar nenit 20 pika 1, shkronja “a”, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekt akte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Neni 43 i Kodit Zgjedhor përcakton se KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme. Ne mungese të një udhëzimi si dhe diktuar nga vendimi nr. nr.28 date 15.06.2023 i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor synohet të përcaktohen rregullat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit në IEVP.

Duke vlerësuar se vendimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor ishte për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, vlerësohet nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

2. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e datës 11 maj 2025, është e domosdoshme të sigurohet që të gjithë qytetarët, përfshirë ata që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar.

Kjo kërkon krijimin e qendrave të posaçme të votimit dhe hartimin e listave të zgjedhësve për këto institucione. Për të garantuar transparencë, integritet dhe akses të barabartë në procesin zgjedhor, është e nevojshme të përcaktohen rregulla dhe procedura të qarta.

Projektvendimi përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEV), hartimin dhe administrimin e listës së zgjedhësve në këto institucione, si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit (KQV).

Projektvendimi synon të sigurojë që zgjedhësit me kushte të veçanta të kenë mundësinë të votojnë në mënyrë të fshehtë dhe të sigurt, duke përmbushur standardet për organizim, siguri dhe aksesueshmëri.

Vendimi përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit dhe administrimin e listës së zgjedhësve në IEVP, si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit për zgjedhjet për Kuvend.

Projektvendimi parashikon që Kryetari i bashkisë përgatit listën e zgjedhësve në përputhje me kreun II të Kodit Zgjedhor si dhe përcakton që KZAZ merr vendim për ngritjen e qendrave të posaçme të votimit dhe propozon krijimin e komisioneve të qendrës së votimit.

Votimi në IEVP zhvillohet në prani të personelit të policisë së burgjeve, KQV-së dhe vëzhguesve, duke siguruar që procesi të jetë i rregullt dhe i sigurt.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor”, i ndryshuar.

Erion META – Drejtor Drejtorja e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOCAJ – Drejtor Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda CELMETA – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data:

Nr:

Ora:

V E N D I M
P E R

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN E QENDRAVE TË POSAÇME TË
VOTIMIT, HARTIMIN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE DHE KRIJIMIN E KOMISIONIT TË
QENDRËS SË VOTIMIT NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE
PENALE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "a" e pika 3, dhe të nenit 43, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin dhe administrimin e listës së zgjedhësve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEV), si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit (KQV) për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

Neni 2

Rregulla të përgjithshme

1. Qendrat e posaçme të votimit sigurojnë ushtrimin e të drejtës për të votuar të zgjedhësve me kushte të veçanta, duke garantuar transparencë, integritet dhe akses të barabartë.
2. Çdo qendër votimi duhet të përmbushë standardet për organizim, siguri dhe aksesueshmeri dhe të garantojë të drejtën e votimit në fshehtësi në përputhje me aktet nënligjore të KQZ-së.
3. Zyra e gjendjes civile pranë njësive të vetëqeverisjes vendore është organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve edhe për institucionet e posaçme në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. DPGJC siguron që personave të cilëve ju është kufizuar/ hequr e drejta për të zgjedhur të mos përfshihen në listat e zgjedhësve.

Neni 3

Hartimi i listës së zgjedhësve

1. Kryetari i bashkisë, gjatë procesit të hartimit të listës së zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi, identifikon si zonë qendre votimi edhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP).
2. Kryetari i bashkisë njofton drejtuesit e IEVP-ve që të identifikojnë dhe të dorëzojnë

Data: xx.xx.2025 Nr:
Ora: xx:xx



Per miratimin e rregullave për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet për kuvend të datës 11 maj 2025

dokumentacionin e nevojshëm për zgjedhësit me të drejtë vote që janë me vendqëndrim në këto institucione të posaçme nën juridiksionin e të cilës ndodhet IEVP.

3. Drejtuesi i IEVP identifikon të gjithë të burgosurit me të drejtë vote në institucionin e posaçëm dhe përjashton nga lista personat që kanë humbur këtë të drejtë.
4. Drejtuesi i Institucionit të Posaçëm (IEVP) përgatit listën e të burgosurve që ndodhen në IEVP deri ditën e zgjedhjeve dhe dërgon këtë listë Kryetarit të Bashkisë nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet IEVP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC) jo më vonë se 60 ditë para ditës së zgjedhjeve.
5. Kryetari i bashkisë nëpërmjet zyrës së Gjendjes Civile të Bashkisë në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile verifikon listën e zgjedhësve, konfirmon listën e zgjedhësve me të drejtë vote sipas rregullave të parashikuara në Kreun II, Pjesa III, të Kodit Zgjedhor dhe ja dërgon KZAZ-së dhe IEVP-së jo më vonë se 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, për secilën zone qendre të votimit ku ndodhen institucionet e posaçme.
6. Drejtuesi i IEVP-së afishon listën e zgjedhësve në ambientet e qendrës së posaçme të votimit.

Neni 4

Krijimi i Qendrave të Posaçme të Votimit

1. KZAZ pas administrimit të listës merr vendim për ngritjen e qendrës së posaçme të votimit dhe i propozon KQZ-së krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit jo më vonë se 35 ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. Komisioneri emëron anëtarët e KQV-së së posaçme ose autorizon KZAZ-në të emërojë anëtarët.
3. Qendrat e votimit që krijohen brenda territorit të IEVP-së identifikohen me numërtimin unik nga kryetari i bashkisë.
4. Drejtuesit e IEVP-se marrin masa të sigurojnë që materialet zgjedhore që mbërrijnë në qendrën e posaçme të votimit të ruhen në përputhje me standardet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 5

Garantimi i sigorisë dhe procesit të votimit

1. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, votimi zhvillohet në prani të personelit të policisë së burgjeve, KQV-se dhe vëzhguesve në përputhje me Kodin zgjedhor dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij
2. IEVP-të marrin masa të sigurojnë dhe lejojnë vëzhguesit e akredituar për këtë qendër votimi si dhe anëtarët e KQV-ve, personelin teknik të KQZ-së të ndjekin procesin e zgjedhjeve në QV në përputhje me rregullat e sigorisë.
3. Drejtuesit dhe personeli i institucioneve të posaçme nuk duhet të ndikojnë apo të sugjerojnë për zgjedhjen e një kandidati apo subjekti zgjedhor nga zgjedhësit në këto qendra të posaçme .
4. Institucionet e posaçme jo më vonë se 48 orë para ditës së zgjedhjeve dërgojnë në KZAZ dhe në KQZ personelin që do të jetë i pranishëm në qendrën e posaçme të votimit, sipas pikës 1 të këtij neni.
5. IEVP-të marrin masa të sigurojnë dokument identifikimi të vlefshme për zgjedhësit e burgosur në mënyrë që ata të votojnë.
6. KZAZ i dërgon IEVP-së jo më vonë se 48 orë para ditës së zgjedhjeve listën me emra të anëtarëve të KQV-së, vëzhguesve të subjekteve politike që do të vëzhgojnë procesin.



7. Ndalohet që një punonjës i burgut të asistojë në mbushjen e fletës së votimit të një zgjedhësi në qendrat e posaçme të votimit.
8. Pajisjet e sigurisë, si kamerat e mbikëqyrjes, vendosen për te verifikuar rregullsinë e procesit dhe nuk duhet të fokusohen tek dhoma e fshehtësisë ku kryhet votimi.

Neni 6

Dispozitat Përfundimtare

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Ngarkohen kryetarët e bashkive, zyrat e gjendjes civile në bashki, DPGJC, IEVP-të dhe KZAZ-të për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilijana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar